

RAPORT

për punën e SHFK “ Imri Elezi ” - Çair, Shkup viti shkollor 2023 / 2024

I. HYRJE

Raporti për punën e shkollës në fund të gjysmëvjetorit të parë në vitin shkollor 2023/2024 është përgatitur në pajtim me Ligjin për arsim fillor (Gazeta zyrtare nr.103/2008 neni 126 alinea 2).

II. KUSHTET NË TË CILAT PUNON SHKOLLA

SHFK “Imri Elezi” gjendet në lagjen Çair në Rr.212 p.n. dhe i përfshin nxënësit nga: I. e Dizhonit, një pjesë të I. Çair dhe një pjesë të I. Xhon Kenedi. Është shkollë qendrore fillore nëntëvjeçare me 34 paralele prej klasës I deri në klasën e IX me mësim në gjuhën shqipe dhe 1 paralele me mësim në gjuhën maqedonase. Gjithësej 35 paralele. Mësimi organizohet në ndërtesën shkollore që gjendet në lagjen e Çairit.

III. PLANIFIKIMI, REALIZIMI DHE NGRITJA E PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR

1. Programi vjetor i punës

Programi vjetor i punës së shkollës është sjellë dhe miratuar nga Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më 15. 08. 2023.

2. Planifikimi dhe realizimi i mësimin

Viti shkollor 2023 / 2024 filloi më 01.09.2023. Gjysmëvjetori i parë zgjati prej 01.09.2023 - 29.12.2023, ndërsa gjysmëvjetori i dytë filloi më 22.01.2024 dhe mbaroi më 17.06.2024. Kohëzgjatja e orëve mësimore ishte 40 minuta. Organizimi i procesit mësimor ishte i planifikuar dhe me sukses i realizuar gjatë gjithë vitit shkollor.

Nga **35210** orë të planifikuara për tërë vitin shkollor prej kl. së I - IX, janë realizuar **34804** orë ose **98.85%**

Paraqitje tabelare e orëve të realizuara sipas lëndëve

I-IX	Gj. amtare		Gj. maqedone		Gj. angleze		Gj.gjermane		Matematik	
	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.
I	900	890	/	/	360	354	/	/	900	892
II	720	705	/	/	288	280	/	/	720	705
III	540	537	/	/	216	206	/	/	540	537
IV	900	900	360	359	510	506	/	/	900	900
V	540	537	216	218	324	321	/	/	540	535
VI	576	579	288	288	432	428	288	279	720	714
VII	432	429	324	320	324	330	216	227	432	432
VIII	432	429	216	214	324	321	216	210	432	430
IX	720	720	288	289	540	541	360	362	720	721
Gjiths. të pl.	5760		1692		3318		1080		5904	
Gjiths. të rea.		5726		1688		3287		1078		5866
%	99.41%		99.76%		99.06%		99.81%		99.36%	

I-IX	Histori dhe shoqëri		Shoqëri		Shkencat natyrore		Biologji		Histori		Gjeografi		Ars. qytetar		Fizik		Kimi	
	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.
I	/	/	180	174	360	348	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
II	/	/	144	138	288	285	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
III	/	/	108	108	216	222	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
IV	360	352	/	/	360	363	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
V	216	213	/	/	216	218	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
VI	/	/	/	/	432	422	/	/	248	245	144	145	/	/	/	/	/	/
VII	/	/	/	/	/	/	216	215	216	210	216	212	/	/	/	/	/	/
VIII	/	/	/	/	/	/	216	214	216	216	216	214	108	107	216	209	216	205
IX	/	/	/	/	/	/	360	359	360	359	360	361	180	180	360	358	360	364
Gjiths. të pl.	576		432		1872		792		1040		936		288		576		576	
Gjiths. të rea.		565		420		1858		788		1030		932		287		567		569
%	98.09%		97.22%		99.25%		99.49%		99.04%		99.57%		99.65%		98.44%		98.78%	

I-IX	Ars. fig.		Ars. muz.		Ars. fiz. e shëndet.		Etika Inovacione		Ars. teknik		Informatik		Gjithsej		Lëndët zgjedhore		Orë kujdestarie		
	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.	plan.	real.		%	plan.	real.	plan.	real.	
I	180	169	180	167	540	533	/	/	/	/	/	/					/	/	
II	144	136	144	139	432	425	/	/	/	/	/	/					144	136	
III	108	108	108	112	324	312	/	/	/	/	/	/					108	102	
IV	180	179	180	177	540	539	/	/	180	182	/	/			360	360	360	354	
V	108	104	108	105	324	317	/	/	216	214	/	/			216	208	108	108	
VI	144	142	144	140	432	428	/	/	80	79	208	204			288	279	144	141	
VII	108	110	108	104	324	314	108	111	/	/	108	105			216	215	108	104	
VIII	108	111	108	107	324	320	/	/	/	/	/	/			216	214	108	106	
IX	180	185	180	179	540	540	180	181	/	/	/	/			360	358	180	180	
Gjiths. të pl.	1260		1260		3780		288		476		316		32222		1656		1332		35210
Gjiths. të rea.		1244		1230		3728		292		475		309	31939			1634		1231	34804
%	98.73%		97.62%		98.62%		101.39%		99.79%		97.78%		99.12%		98.67%		92.42%		98.85%

1. Planifikimi dhe realizimi i aktiviteteve jashtëmësimore

a). Aktivitete të lira –

Puna e aktiviteteve të lira u realizua gjatë gjithë vitit shkollor përmes sekcioneve të formuara në mësimin klasor dhe lëndor sipas planifikimit në Programën vjetore të shkollës, si dhe planifikimeve të të gjithë mësimeve në Planprogramet e tyre vjetore për aktivitete të lira, kurse diturisë e arritura nga puna e sekcioneve u prezentuan në shfaqje, në gara të ndryshme dhe konkurse të organizuara në shkollë dhe jashtë saj.

Më 12.09.2023 tre mësime morën pjesë në trajnimin e radhës në Kroaci në kuadër të projekteve Erasmus+. Përdorimi i metodave të reja në zhvillimin e procesit arsimor në shekullin XXI-të, ishte tema e trajnimit pesëditor në Split. "Bashkimi i pjesëve të figurave", "Mësimi i bazuar në kërkim", "Mësimi i bazuar në projekt", "Klasa e kthyer", "Të mësuarit me bashkëpunim" dhe "Mësimi i bazuar në probleme" ishin disa nga metodat e shtjelluara.

Pjesë e këtyre ditëve ishte edhe vizita e institucioneve dhe vendeve të bukura, duke gjetur kohë edhe për bizneset e suksesshme me pronar shqiptar.

15.09.2023 nxënësit e shkollës sonë filluan trajnimet me organizatën CID dhe Qendrën "Racio". Në të njëjtën kohë, të ndarë në dy grupe të mëdha, ata me përkushtim zhvilluan aktivitetet me temë "Dhuna nga bashkëmoshatarët (bullizmi)" dhe "Pjesëmarrja lokale e të rinjve është e rëndësishme".

Më datën 22.09.2023, klasat e pesta V-1, V-2 dhe V-3, vizituan Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aty nga afër u njoftuan me funksionin dhe veprimtarinë e Kuvendit, sipas plan-programit të lëndës së historisë dhe shoqërisë.

Më datën 29.09.2023 nxënësit dhe mësimeve të shkollës sonë morën pjesë në aktivitetin në kuadër të Javës Evropiane të Sportit, ku biçikleta ishte kryefjala.

Më 05.10.2023 klasa e tretë në bashkëpunim me bibliotekisten dhe mësuesen e realizuan aktivitetin me temë "Vozit ndërgjegjshëm!".

Nxënësit nëpërmjet videove, lojërave, vjershave e këngëve u njoftuan për shenjat e komunikacionit dhe kujdesin që duhet treguar në komunikacion. Në këtë aktivitet nxënësit morën nga një dhuratë prej bibliotekistes.

Dedikimi i Javës së Fëmijëve është një rast për të shprehur dashurinë, kujdesin dhe mbështetjen ndaj fëmijëve në shoqëri. Gjatë kësaj jave, njerëzit mund të angazhohen në aktivitete dhe iniciativa të ndryshme për të nxitur mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe për të theksuar rëndësinë e tyre në shoqëri. Më 06.10.2023 e shënuam ditën e pestë të "Javës Botërore të Fëmijëve" duke vizituar kopshtin zoologjik për ti shoqëruar dhe për ti gëzuar nxënësit e klasës së parë.

Në muajin tetor mësimeve nga dy shkolla turke dhe një belge, ishin për vizitë pune njëjavore në shkollën tonë përmes projektit të Erasmus+. Vizita në objektin e shkollës, njohja me sistemin arsimor dhe vizitat në vendet me rëndësi kulturore, historike e turistike e plotësuan agjendën e punës në këtë javë. Krahasimi i sistemit edukativ e arsimor në Maqedoninë e Veriut me atë në Turqi dhe Belgjikë, krijoi përvoja reciproke ndërmjet partnerëve.

Më 5 Tetor 2023 u shënuar Dita Ndërkombëtare e Mësuesit në shkollën tonë nga ana e grupit letrar dhe gazetaresk-hulumtues bashkë me mësimeve të përgjegjës.

Më 20.10.2023 u përkujtua dita e lindjes, 23.10.1978 së heroit tonë që mban emrin shkolla jonë "IMRI ELEZI" ku ai mbaroi shkollimin fillor, në mënyrë solemne, me një manifestim të përgatitur nga ana e nxënësve me poezi, ese, valle dhe pika muzikore.

Komuna e Çairit në bashkëpunim me CIVILin sot në Sheshin Wodroow Willson mbajtën manifestimin multimedial “Bashkë për ardhmëri më të mirë”, pjesë e projektit me të njëjtin emër dhe qëllimi i të cilit është promovimi i multikulturalizmit dhe vlerave evropiane në vend, me fokus të veçantë tek të rinjtë.

Nxënës nga nëntë shkollat fillore të Komunës së Çairit morën pjesë në konkurs me një përzgjedhje të punimeve krijuese, të cilat ishin pjesë e ekspozitës.

Gjatë muajit dhjetor mësimdhënës të Shkollës Fillore Komunale “Imri Elezi” kanë kryer projektin njëvjeçar në lidhje me zbatimin e metodave bashkëkohore të nxënësit me nevoja të veçanta, brenda dhe jashtë institucioneve. Përvojat e fituara nga ky projekt janë përcjellë në hapësirat e shkollës sonë. Trajnimet e ndara në katër pjesë, u realizuan në katër periudha me ndihmën e trajnuesve të specializuar nga Kroacia. Dy trajnime janë mbajtur në Sllatinë të Kroacisë, tjetri në Split të Kroacisë dhe i fundit në Pragë të Çekisë.

Më 31 Janar nxënësit e shkollës sonë mbaruan serinë e ligjëratave në kuadër të projektit “Youth participation matters”, realizuar nga Qendra Racio në Shkup dhe organizata CID në Kumanovë. Përmes aktiviteteve të ndryshme në këtë projekt është promovuar pjesëmarrja lokale e të rinjëve dhe luftimi i dhunës nga bashkëmoshatarët. Më 1 mars shfaqja teatrale “12 muajt e vitit” u realizua në gjuhën maqedonase në Teatrin për Fëmijë. Kjo shfaqje është ndjekur nga nxënësit e klasës së katërt, në kuadër të lëndës Gjuhë maqedonase për bashkësitë. Për nder të “7 Marsit-Ditës së Mësuesit” sot nxënësit e shkollës sonë organizuan program për të përkujtuar themelimin e Mësonjëtorës së parë shqipe në Korçë.

Për nder të Ditës së Ekologjisë (Ditës së Pranverës) -21 Mars, grupi i ekologëve të rinj me ndihmën e arsimtarit të biologjisë në mënyrë simbolike mbollën disa fidane pemësh në kopshtin e shkollës sonë.

Më 23 prill Ditën Ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtave Autoriale, nxënësit e shkollës sonë së bashku me bibliotekisten e shkollës e vizituan Panairin Ndërkombëtar të Librit - Shkup 2024 që u mbajt në Arenën Sportive - A1.

Më 26 prill Bibliotekën e qytetit “Vëllezërit Milladinov” - Shkup u mbajt orë letrare - “Ditët e Naim Frashërit”.

Nxënësit recituan me një gjuhë të pasur poetike duke ia kushtuar Rilindasit tonë, mësuesit të madh të popullit që me vargje na e mësoi lirinë, na mësoi se si duhet atdheu, thuri ylberin e diturisë e na stolisi me dije për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen.

Gjatë muajit Qershor u mbajtën edhe festat e abetarës nga klasat e I-ra dhe të II-ta.

b). Garat e nxënësve –

Nga datat 5 deri më 9 Tetor 2023 u mbajt turneu ndërkombëtar në mundje ' Lutfi Amedov' në qytetin bullgar Razgrad, në të cilën morrën pjesë këto shtete - Bullgaria, Turqia, Rumania, Maqedonia e Veriut, Moldavia dhe Danimarka. Në një konkurrencë të fortë pas katër ndeshjeve nxënësi ynë Jetmir Ahmeti zuri vendin e parë-medaljen e artë, kurse nxënësi Sufjan Sinani gjithashtu pas katër ndeshjeve zuri vendin e dytë-medaljen e argjendtë.

Më 28.11.2023 në shkollën tonë u realizua konkurs letrar për nder të “28 Nëntorit-Ditës së Flamurit”. Në këtë konkurs morën pjesë nxënësit me krijime letrare-poezi dhe ese. Nxënësit u vlerësuan nga anëtarët e përzgjedhur të komisionit. Nxënësit u shpërblyen me libra dhe mirënjohje.

Gara republikane në SHAH më 30.11.2023-Pjesëmarrja në gara republikane, edhe pse debituese ishte me mjaft sukses. Pjesëmarrës ishin nxënës nga shkollat fillore që gravitojnë në komunën e Çairit, dhe nxënës që tanimë janë në shkolla të mesme po nga kjo komunë.

Mbresë në këtë garim ,përpos atyre të dëshmuarve ,vihet në pah ardhmëria e disa nxënësve që janë në klasën e II,III,IV
Në kuadër të OJQ „ULIÇER " u organizua një turne e shahut ku morën pjesë dhjetë shkolla nga Komuna e Çairit dhe Tetovës , ku nxënës të shkollës sonë fituan vendin e parë -IDRIS TAIRI dhe OMER NEZIRI .
Në muajin Maj u mbajt turneu tradicional “Imri Elezi 2024”, ku me 31.05.2024 u mbajt finalja e turnout dhe shkolla jonë morri vendin e dytë.

c). Parlamenti i nxënësve – Parlamenti i nxënësve në nivel të shkollës, rregullisht mbajtën takime në të cilat - tema kryesore të diskutimit ishin: sukcesi, disiplina, rregullshmëria, komunikimet ndërmjet tyre, analiza dhe vlerësimi i rezultateve nga puna dhe sjellja e nxënësve, etj. Poashtu u mbajtën punëtori debative në të cilat u dhanë ide dhe u morrën iniciativa për parandalimin e dhunës në shkollë dhe jashtë saj. Në kuadër të parlamentit të nxënësve u organizua punëtori me nxënësit e kl.VI-IX për vetëdijësimin e nxënësve rreth fenomenit të Bullizmit në shkollë nga ana e bashkëpunorëve profesional. Gjithashtu, gjatë tërë vitit shkollor nga bashkëpunimi i përbashkët dolën iniciativa, u dhanë ide dhe u përpiluan disa projekte për përmirësimin e kushteve dhe ambientit në shkollë, projekte të suksesshme që vlen të përmenden si: Të gjitha këto aktivitete janë bërë në bashkëpunim me bashkësin e nxënësve në nivel të shkollës.

d). Puna prodhuese dhe punë të tjera shoqërore – Aktivitetet nga puna prodhuese dhe shoqërore ishin të orientuara kah rregullimi dhe pastrimi i lokaleve të shkollës, oborrit me rrethinë, punimit të mjeteve didaktike mësimore, akcionet ekologjike, rregullimi i panove në shkollë etj., ku në mënyrë aktive morrën pjesë jo vetëm anëtarët e sekcioneve, por edhe të gjithë të tjerët të udhëhequr nga kujdestarët e klasave të tyre. Edukimi ekologjik zhvillon diturinë, ndërgjegjësimin, vlerat dhe aftësitë që do ti mundësojë shoqërisë të ruajë dhe të përmirësojë cilësitë e mjedisit ku jeton.Një aktivitet i tillë u realizua nga bibliotekistja e shkollës dhe nxënësit e klasës IX-2 të cilët realizuan pastrimin e oborrit të shkollës me të vetmin qëllim: mbrojtja e mjedisit ku bashkëveprojmë përbën një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë. Me vetëdijen se jemi duke ndihmuar vetveten, e motivuam njëri-tjetrin për të marrë qeset, dorezat dhe kapëset për të pastruar hapësirën rreth shkollës - projekti #WeekendGeneral, ku nxënësit dhe mësime të shkollës sonë morën pjesë.

4. Kujdesi për shëndetin e nxënësve -

Aktivitetet nga kjo lëmi i përfshijnë: vaksinimet dhe kontrollimet e rregullta sistematike (në kl. I, II, III, V, VI, VII VIII dhe kl. IX -ta). Gjithashtu janë bërë edhe kontrollime sistematike stomatologjike tek nxënësit e kl. I, II, III, IV dhe V. Në këtë kontekst janë mbajtur edhe ligjerata me nxënësit dhe arsimtarët me temë: “ Mirëmbajtja e dhëmbëve“ realizuar nga stomatologët e Poliklinikës së Çairit, poashtu ligjerata të ndryshme për higjienë dhe shëndet janë mbajtur edhe nga ana e aktivistëve të KK dhe institucioneve të tjera përkatëse.

5. Bashkëpunimi me rrethin lokal –

Edhe këtë vit shkollor prindërit ishin të kyçur në procesin edukativo - arsimor përmes takimeve grupore dhe individuale, si dhe përmes organit të formuar – Këshillit të prindërve i cili aktivisht mori pjesë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, parasëgjithash në temat: disiplinë, financa, vlerësim, përcjellje të suksesit dhe aktiviteteve të tjera. Në këto mbledhje është diskutuar për punën e shkollës, për inovacionet në arsim dhe planprogramet mësimore, për raportet periodike të suksesit , sjelljen e nxënësve dhe masat që janë marrë për përmirësimin e saj, për gjendjen materiale dhe kushtet e punës në shkollë dhe mënyrat e përmirësimit të tyre.

6. Përcjellja, vlerësimi dhe ngritja e procesit edukativo – arsimor në shkollë

Në kontinuitet është bërë përcjellja, analiza dhe vlerësimi i kualitetit dhe rezultateve mësimore si dhe aktiviteteve jashtëmësimore, duke ndërrmarë masa konkrete dhe aktivitete profesionale për bashkëkohësimin , modernizimin dhe ngritjen e kualitetit të procesit mësimor. Për përcjellje dhe vlerësim shfrytëzuam vizitat në orë, të dhënat e ndryshme nga dokumentacioni pedagogjik, pasqyrat tabelare, të dhënat statistikore etj.

Për ngritjen dhe modernizimin e procesit mësimor dhe lëmive jashtëmësimore, mësimdhënësit i shfrytëzuan dhe do ti shfrytëzojnë njohuritë e nxëna në seminare, nga vizitat në shkolla tjera dhe këmbimi i përvojave si dhe nga vetë realizimi i projekteve në të cilat është e kyçur shkolla.

7. Ngritja profesionale dhe pedagogjike e arsimtarëve dhe punëtorëve tjerë profesional

Seminare dhe trajnime: Për aftësimin e kuadrit arsimor për tu shërbyer me forma, teknika dhe metoda bashkëkohore të punës dhe për ngritjen e cilësisë së punës në përgjithësi, një pjesë e mësimdhënësve, bashkëpunëtorët profesional dhe drejtori, morrën pjesë në disa seminare dhe trajnime të organizuara nga BZHA, USAID dhe MASH siç janë:

SEMINARE	KOHA E REALIZIMIT	PJESËMARRËS
Strategjitë për menaxhim në klasë-parimet dhe shembujt e praktikës së mirë për krijimin e atmosferës pozitive në orë- BZHA.Akademia CES	16,17.08.2023	Të gjithë mësimdhënësit
Të rinjtë mendojnë për edukim mediatik- BZHA,USAID	18.01.2024	Mësimdhënëset e klasave të ulëta dhe mësimdhënëset e GJ.shqipe
Trajnim për përdorimin e librave digjital - MASH	26.01.2024	Fatmire R., Drandofile R.,Sejlan Sh.,Shkendije I., Nertila P., Bunjamin E., Luiza M.,Arjeta Ç., Arbana V., Medina L., Sumeja B., Elmjesa A., Irjeta I., Elena S., Fatmire M., Suela I., Blerta L..
Proekt për përmirësimin e arsimit fillor – “ Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhimin e shëndetit menstrual dhe higjienës”- MASH	04.04.2024	Selime E., Sueda R

Puntori për avancimin e shëndetit mendor të adoleshentëve në arsim	18-19.04.2024	Zymrije A., Selime E., Sueda R.
Roli i femrës për zbulim të hershëm të kriminalit dhe krijimi i një komuniteti më të sigurt - MPB	21.05.2024	Sueda R.
Organizimi sindikal	14,15.08.2024	Sabri R.

IV. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS TË ORGANEVE PROFESIONALE, BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL DHE DREJTORIT

1. Këshilli arsimor – Këshilli arsimor mbajti 5 mbledhje të rregullta dhe disa të jashtëzakonshme ku u shqyrtuan: Programi vjetor, analizat dhe raportet periodike të suksesit dhe sjelljes së nxënësve deri në fund të gjysmëvjetorit të I - rë, novitetet dhe ndryshimet në arsim, pyetje të ndryshme mbi sjelljen, rregullshmërinë dhe disiplinën, aktivitetet jashtëmësimore, marrja e masave pedagogjike ndaj nxënësve gjegjësisht etj.

2. Këshilli i klasave – Këshilli i klasave mbajti 5 mbledhje të rregullta dhe disa mbledhje të jashtëzakonshme ku u shqyrtuan suksesi dhe sjellja e nxënësve, aftësitë e kufizuara të disa nxënësve, mënyrat e zgjidhjes së problemeve ekzistuese siç janë: mosdisiplina dhe notat e dobëta, propozime për masa pedagogjike etj.

3. Këshilli i shkollës – Këshilli i shkollës 3 mbledhje. Në mbledhjen e mbajtur më 15.08.2023 u miratua Programi vjetor i punës për vitin shkollor 2023 /2024, ndërsa në mbledhjet tjera u shqyrtuan probleme të natyrave të ndryshme me rëndësi.

4. Kujdestari i klasës – Kujdestarët e klasave vazhdimisht bënin përcjelljen e të arriturave dhe zhvillimin e nxënësve në klasë, bashkëpunuan me prindërit, mësuesit, bashkëpunëtorët profesional dhe drejtorin dhe të njejtë rregullisht i informonin mbi të arriturat dhe problemet e nxënësve; mbanin biseda individuale me nxënësit dhe prindërit, kujdeseshin për edukimin e nxënësve dhe realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore, kujdeseshin mbi shëndetin e nxënësve dhe higjienën e tyre personale etj.

5. Aktivet profesionale – aktivet e mësimit klasor të formuara sipas klasave dhe aktivet profesionale nga të gjitha lëndët në ciklin e lartë punuan sipas planifikimeve të përgatitura më parë . Në mbledhjet e aktiveve u diskutuan këto pyetje: zgjedhja e kryesisë së aktivitetit dhe përpilimi i plan-programit për punën e aktivitetit; integrimi i njësive mësimore në lëndë të ndryshme; identifikimi i nxënësve me të arritura më të ulta dhe nxënësve me nevojë të veçanta, ndarja e angazhimeve mes mësuesve për realizimin e aktiviteteve të lira, u dhanë këshilla dhe u këmbyen eksperiencat për tejkalimin e problemeve etj. Janë mbajtur edhe orë të hapura të cilat ishin të planifikuara në planprogramet e aktiveve dhe Programën vjetore të shkollës.

6. BASHKËPUNËTORËT PROFESIONAL

Pedagogu – Pedagogu i shkollës me sukses realizoi më tepër aktivitete programore: vlerësimin dhe regjistrimin e fëmijëve në klasë të I-rë me metodën e vëzhgimit; mbajti biseda individuale dhe grupe me nxënës të të gjitha grupmoshave me qëllim të zgjidhjes së drejtë të problemeve të lidhura ngushtë me mësimin dhe sjelljen e tyre; bashkëpunoi me psikologun, drejtorin, mësimdhënësit, dhe prindërit; bashkëpunim dhe këshilla me mësimdhënësit për realizim të suksesshëm të procesit edukativo-arsimor; përcjellje dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore; pjesëmarrje aktive në përgatitjen e Programit vjetor të shkollës; pjesëmarrje në përgatitjen e raporteve periodike mbi suksesin dhe sjelljen e nxënësve; mbajtja e evidencës për suksesin prej kl. së I – IX, informim dhe këshillime me nxënësit në bashkëpunim me prindërit dhe mësimdhënësit, vazhdimisht bashkëpunonte me mësimdhënësit për udhëheqjen e drejtë të dokumentacionit pedagogjik dhe mbi punën në tërësi në shkollë.

Mori pjesë në mbledhjet e aktiveve profesionale, mbledhjet e Këshillit të klasave dhe ato arsimore; bashkëpunoi me BZHA-në, MASH-in, Shoqatën dhe Sekcionin e pedagogëve dhe me bashkëpunëtorët profesional të komunës së Çairit si dhe institucione të tjera; angazhim dhe organizim të punëtorive të ndryshme varësisht moshës dhe gjinisë së nxënësve, në fushën e higjienës, shëndetit, etj. në bashkëpunim me persona profesional nga institucione përkatëse, OJQ etj.

Pedagogu dhe psikologu përpiluan listën e fëmijëve që i plotësojnë kushtet për regjistrim në klasë të I-rë – si kërkesë nga inspektorati për arsim dhe shkencë, gjatë muajit maj dhe qershor u bë edhe regjistrimi i nxënësve në klasë të parë sipas listës së dërguar nga MPB dhe rajonizimit në nivel komunal.

Si anëtare të Eko Bordit së bashku me psikologun u kyçën në aktivitetet e eko-patrullave në realizimin e akcioneve ekologjike të planifikuara dhe të realizuara gjatë gjithë vitit shkollor. Pjesëmarrje në seminare dhe trajnime në tema të ndryshme, për ngritjen e cilësisë së punës në shkollë etj.

Psikologu – Psikologu i shkollës me sukses i realizoi aktivitetet si vijon: vlerësimin dhe regjistrimin e fëmijëve në kl. të I-rë me metodën e vëzhgimit, përcjelljen e zhvillimit dhe adaptimit të nxënësve, sidomos të nxënësve me nevoja të veçanta, mbante biseda individuale dhe grupe me nxënësit, arsimtarët dhe prindërit për tejkalimin e problemeve, bashkëpunoi me pedagogun, drejtorin, arsimtarët, dhe prindërit, përcjellje dhe pjesëmarrje në aktivitetet mësimore dhe jashtëmësimore, përgatitje dhe realizim të disa punëtorive psikologjike me nxënës, mbajtja e evidencës për suksesin prej kl. së I – IX, informim dhe këshillime me nxënësit në bashkëpunim me prindërit dhe arsimtarët.

Mbante llogari për udhëheqjen e drejtë të dokumentacionit pedagogjik dhe mbi punën në tërësi në shkollë, bashkëpunoi me institucione dhe shoqata tjera (komunën, BZHA-në, MASH-in, Entin për shëndet mental të fëmijëve dhe të rinjve” Mlladost”, sektionin e psikologëve në nivel të qytetit dhe me bashkëpunëtorët profesional të komunës, me shkolla tjera fillore dhe të mesme etj.); pjesëmarrje aktive në realizimin e projekteve në shkollë; pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit të klasave dhe ato arsimore, pjesëmarrje aktive në përgatitjen e Programit vjetor të shkollës dhe përgatitjen e raporteve periodike mbi suksesin dhe sjelljen e nxënësve etj.

Psikologu dhe pedagogu përpiluan listën e fëmijëve që i plotësojnë kushtet për regjistrim në klasë të I-rë – kërkesë nga inspektorati për arsim dhe shkencë, gjatë muajit maj dhe qershor u bë edhe regjistrimi i nxënësve në klasë të parë sipas listës së dërguar nga MPB dhe rajonizimit në nivel komunal.

Në lidhje me miratimin e Ligjit të ri për këshillimin e prindërve u mbajtën puntori nga ana e psikologut me prindërit e nxënësve me sjellje jo të mire, mungesa në mësim dhe sukses të dobët si dhe punëtori me nxënësit në të njëjtat tema.

Si anëtare të Eko bordit së bashku me pedagogun e shkollës u kyçën në aktivitetet e eko-patrullave në realizimin e akcioneve ekologjike të planifikuara dhe të realizuara gjatë gjithë vitit shkollor. Pjesëmarrje në seminare dhe trajnime në tema të ndryshme, për ngritjen e cilësisë së punës në shkollë etj.

Defektologu - Në pajtueshmëri me programin e pregaditur për punën e defektologut të shkollës, pranë shkollës fillore “ Imri Elezi “ – Shkup, janë paraparë qëllimet dhe përmbajtjet e realizimit të programit të vitit shkollor 2023/2024. Qëllimet dhe përmbajtjet e realizuara janë: detektimi I fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollë, udhëheqje e dokumentacionit pedagogjik dhe evidentimi të nxënësve, përmbajtje e nxënësve në procesin arsimor, përmbajtje e mësimdhënësve dhe prindërve, punë individuale me fëmijët me NP, si dhe kyçje ose integrim në punë të shërbimit profesional në shkollë.

Detektimi i fëmijëve me nevoja te veçanta

Në gjysmëvjetorin e parë të viti 2023 në shkollën fillore “Imri Elezi “ – Shkup, mësimin e kanë ndjekur 15 nxënës me nevoja të veçanta. Në këtë gjysmëvjetor gjatë procesit edukativo-arsimor 6 nxënës me aftësi te veçanta kanë pas si shoqërues asistente arsimore. *Udhëheqje e dokumentacionit pedagogjik, vëzhgim*

Për fëmijët me nevoja të posaçme të cilët posedojnë dokumentacion dhe rekomandim mjekësorë dhe nga ana e shëndetit mental, gjatë gjysmëvjetorin e parë janë udhëhequr në dosie speciale të cilët në vete kanë përmbajtur dokumente për vlerësimin e gjendjes funksionale të fëmijës, vlerësim gjatë punës individuale nga ana e defektologut, vëzhgim gjatë orës së mësimin, mendim prej mësimdhënësve dhe prindërve.

- Për fëmijët të cilët kanë vështirësi në realizimin e programit të regullt mësimor, janë pregaditur plane individuale mësimore PIA (në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe prindërit) të cilët e kanë për qëllim lehtësimin e procesit arsimor të kësaj kategorie fëmijësh, të definuara saktësisht qëllimet dhe metodat e punës.

Përmbajtje mësimore e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve

Në këtë gjysmëvjetor, prindërve, nxënësve dhe mësimdhënësve ju është dhënë vazhdimisht mbështetje dhe përkrahje në procesin arsimor. Janë bërë konsultime me mësimdhënësit rreth mënyrës punuese dhe metodike për fëmijët me nevoja të veçanta, vlerësimi, bërja e testeve dhe socializimin tek fëmijët. Nëpërmejt organizimive dhe aktivitetve profesionale, prezentimeve dhe ligjeratave në mënyrë profesionale kanë qenë të siguruara përparimi i kuadrit mësimor, me qëllim që mësimdhënësit me suksese të ju përgjigjen nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Me *prindërit bashkëpunimi* ka qenë pjesërisht, gjatë gjysmëvjetorit kanë qenë të realizuara disa takime, ku janë diskutuar tema për mënyrën punuese me fëmijën, nevojat dhe qëllimet e PIA si dhe mënyrën funksionale e nxënësit në shkollë dhe shtëpi.

Nxënësit me nevoja të veçanta, gjatë kohës kanë qenë të opservuar në orë të mësimin, me qëllim që të shihet niveli se si realizohet përmbajtja mësimore, pranimi i nxënësit me nevoja të veçanta në klasë, si dhe detektimi eventual e disgrafisë, disleksisë si dhe probleme grafomotorike. Me një pjesë të nxënësve është punuar individualisht një herë në javë.

Puna individuale me nxënësit me nevoja të posaçme (NP)

Në këtë gjysmëvjetor individualisht është punuar me 15 nxënës me nevoja të posaçme (NP), 9 nxënës kanë qenë prej grupit klasor dhe 6 nxënës prej grupit lëndorë. Me nxënësit është punuar një herë në javë me periudhë kohore prej 40 minuta. Me ata kemi punuar

ushtrime për përmirësimin e psikomotorikës, ushtrime për grafomotorikën, orjentimi në vend dhe hapësirë, lateralizimi dhe njohja e pjesëve të trupit, janë bërë teknika për ushtrimin e leximit dhe shkrimit, si dhe janë përpunuar dhe janë thjeshtëzuar ato përmbajtje mësimore në të cilat nxënësit janë ballafaquar me vështirësi.

7. Puna e drejtorit

Drejtori i vazhdoi pa ndërprerë të gjitha aktivitetet e parashikuara dhe në mënyrë aktive bashkëpunoi me të gjithë subjektët e involvuar në procesin edukativo-arsimor në shkollë. Të gjithë mësimdhënësit ishin të motivuar të vizitojnë seminarët dhe zbatimin e suksesshëm në praktikë të njohurive të tyre profesionale. Realizimi i mësimit të rregullt dhe atij jashtëmësimor ishin përcjellur në kontinuitet nga ana e drejtorit nëpërmjet vizitave në orë, vlerësimeve, bashkëpunimeve, diskutimeve dhe konsultimeve, gjë që kontriboi në ngritjen dhe efikasitetin e punës. Për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të planifikuara nga programi vjetor, drejtori në mënyrë aktive bashkëpunoi me bashkëpunëtorët profesional, mësimdhënësit dhe të gjithë subjektet tjerë në shkollë, si dhe me BZHA-në, MASH-in, komunën dhe institucione tjera kulturore – arsimore.

Rregullisht i udhëhiqte mbledhjet e Këshillit të klasave, mbledhjet e Këshillit arsimor dhe merrte pjesë në mbledhje të Këshillit të shkollës dhe atë të Këshillit të prindërve dhe në pajtim me ingerencat e tij merrte pjesë në zgjidhjen e problemeve ekzistuese, prezentonte raporte për punën e shkollës, bënte analiza dhe vështrime kritike, gjatë së cilës jepte propozim masa për përmirësimin e punës së tërësishme në shkollë. Me shfrytëzimin e drejtë dhe adekvat të mjeteve financiare drejtori me sukses zgjidhi disa probleme si sigurimi i mjeteve didaktike dhe veglave ndihmëse etj.

Më 02.10.2023 në shkollën tonë në bashkëpunim me komunën dhe kryetarin Visar Ganiu, u lëshuan në përdorim panelet solare që janë vendosur përmes projektit “CBC Ekokid” e që u zbatua nga Komuna e Çairit në partneritet me Komunën e Ferizajit dhe OJQ-në BSCK Kosova dhe i mbështetur nga Bashkimi Evropian përmes IPA Programit për Bashkëpunim Ndërkufitar Kosovë – Maqedonia e Veriut 2014 - 2020.

Bashkëpunimi i ndërsjelltë me inspektoratin për arsim gjatë çdo vizite nga ana e tyre.

V. ANALIZA E SUKSESIT DHE SJELLJES SË NXËNËSVE NË FUND TË VITIT SHKOLLOR 2023/2024

Këtë vit shkollor mësimin e kanë ndjekur 909 nxënës prej klasës I – IX, 907 me mësim në gjuhën shqipe dhe vetëm 2 nxënës në kl.IX me mësim në gjuhën maqedone.

Analiza e suksesit

Në fund të këtij viti shkollor gjatë analizës së suksesit u konstatua se sukcesi i përgjithshëm me (4.09), është më i ulët në krahasim me vitin e kaluar shkollor, ku sukcesi i përgjithshëm ishte (4.12), ndërsa në vitin shkollor 2021/22 sukcesi i përgjithshëm ishte (4.13).

Paraqitje tabelare e notës mesatare sipas klasave për tre vitet e fundit

Nxënësit prej klasës I - III janë të përfshirë me notim përrshkrues.

Viti shkollor	2023/24	2022/23	2021/2022
IV	4.36	4.30	4.20
V	4.27	4.23	4.26
VI	3.91	4.01	4.11
VII	3.82	3.81	4.53
VIII	3.76	4.41	3.75
IX	3.82	3.99	3.92

Në paralelet me mësim në gjuhën shqipe sukses më të lartë prej kl. së IV- IX kanë treguar kl. e IV -2 me 4.70 dhe kl. VII-1 me 4.46 notë mesatare, ndërsa sukses më të ulët kanë treguar kl. VII -2 me 3.35

Suksesi më i lartë i arritur sipas klasave						
paralelja	IV	V	VI	VII	VIII	IX
klasa	IV-2	V-1	VI -1	VII -1	VIII -1	IX -2
Nota mesat.	4.70	4.36	4.12	4.46	4.13	4.20

Analiza e suksesit për tre vjet me radhë është si vijon:

Viti shkollor	2023/24	2022/23	2021/2022 %
Gjithsej me notë pozitive	98.96%	99.05%	99.79%
Me sukses të shkëlqyeshëm	45.57%	43.24%	46.47%
Me sukses shumë mirë	22.09%	24.95%	23.13%
Me sukses të mire	24.52%	26.29%	26.27%
Me sukses të mjaftueshëm	6.78%	4.71%	3.92%
Me nota të dobëta	0.87%	0.19%	/
Të panotuar	/	0.57%	0.20%

Nxënës me nota të dobëta dhe që do ta përsëritin vitin shkollor janë: 1 n. Në kl.VI, 3 nx. Në kl VII dhe 1 në kl. e VIII, ndërsa 1 nx. me notim përshkrues tek klasa V/3.

Analiza e mungesave dhe sjelljes për tre vjet

Mungesat

Viti shkollor	2023/24			2022/2023			2021/2022		
Gjinia	M	F	Gj.	M	F	GJ	M	F	Gj.
Të arsyeshme	1675	958	2633	571	322	893	782	433	1215
Të paarsyeshme	1126	792	1918	530	250	780	454	238	692
Gjithsej	2801	1750	4551	1101	572	1673	1236	671	1907

Analiza tregon se këtë vit shkollor kemi rritje të madhe të numrit të mungesave në krahasim me 2 vitet e kaluara.

Sjellja

Viti shkollor	2023/24	2022/2023	2021/2022
Shembullore	903 (99.38%)	842(99.53%)	795(99.25%)
Mirë	6(0.62%)	4(0.47%)	4(0.50%)
Pamjaftueshëm	%	/	2(0.25%)

VI. EVIDENCA PEDAGOGJIKE DHE DOKUMENTACIONI

Gjatë gjithë vitit shkollor vazhdimisht mbahej evidencë pedagogjike dhe dokumentacioni i cili përbëhet nga libri klasor , libri kryesor, listat evidentuese, dëftesat, fletë-shpërnguljet, ditarit për punën e shkollës dhe librave për procesverbale. Të gjithë arsimtarët u përmbaheshin udhëzimeve të dhëna për udhëheqjen e evidences pedagogjike dhe dokumentacionit. Dokumentacioni është kontrolluar rregullisht. Poashtu rregullisht udhëhiqej edhe ditari elektronik.

VII. PROPOZIM MASA

Si propozim masa për përmirësimin e gjendjes dhe për ngritjen e procesit edukativo-arsimor do të përmendim: shfrytëzimin më të shpeshtë të mënyrave dhe metodave hulumtuese në procesin mësimor; përcjelljen dhe kyçjen e shkollës në projekte të reja, si dhe realizim aktiv dhe përgjegjës të projekteve ekzistuese; sigurim të sponsorimeve dhe donacioneve, granteve; ndjekja e literaturës profesionale nga ana e kuadrit arsimor; këmbimi i eksperiencave me shkollat tjera dhe institucionet përkatëse; zbulimin e mënyrave për motivim më efikas të nxënësve, por edhe të të punësuarve për krijimin e klimës pozitive në shkollë, ku do të kalitet dashuria për punë dhe kualitet; do të bëhet përmirësimi i kushteve për punë; synim drejt sigurimit të burimeve të reja financiare duke përpiluar dhe duke aplikuar me projekte të reja, me çka do të përmirësohen kushtet në tërësi për punë dhe mësim në shkollë etj.

Shtojcë: Raporti statistikor

D R E J T O R

LULZIME ISLAMI